

Në bazë të nenit 24-a, paragrafit 18, të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20, 78/25 dhe 132/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

## RREGULLORE

### për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkolllore për nxënësit e shkollave të mesme

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e realizimit të ekskursioneve shkolllore për nxënësit e shkollave të mesme.

##### Neni 2

Ekskursionet shkollore paraqesin formë të punës edukativo-arsimore që realizohet përmes aktiviteteve të ndryshme jashtë shkollës me vizita në: vende natyrore dhe turistike, institucione arsimore, kulturore dhe sportive, objekte teknike dhe teknologjike dhe lokalitete të tjera, në përputhje me qëllime dhe objektiva të caktuara nga programet mësimore dhe fushat për zhvillimin dhe realizimin e interesave të ndryshme të nxënësve

#### II. LLOJET E EKSURSIONEVE

##### Neni 3

**Ekskursionet shkollore mund të janë:**

- Ekskursione të lidhura me tema dhe përbajtje nga programet mësimore,
- Ekskursione përfundimtare,
- Ekskursione profesionale-hulumtuese dhe
- Ekskursione sportive-rekreative.

Ekskursionet e lidhura me tema dhe përbajtje nga programet mësimore përfshijnë vizita në shfaqje teatrale, opera, balet, si dhe vizita në muze në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ekskursionet e fundit përfshijnë aktivitete për të mësuar rrith vlerave kulturore dhe estetike në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në një vend tjetër.

Ekskursionet profesionale-hulumtuese përfshijnë aktivitete për arritjen e qëllimeve të integruara nga disa programe mësimore që janë në interes të sektorit, aktivitete projektore ose përbajtje të programuara nga shkolla.

Ekskursionet sportive dhe rekreative përfshijnë: pushimet dimërore, pushimet verore, aktivitetet edukative dimërore/verore, kampingjet dhe daljet njëditore që zhvillohen jashtë shkollës për të ndërtuar dhe arritur kulturën sportive, për të zhvilluar zakone rekreative, për të inkurajuar socializimin dhe për të promovuar stil jetese më të shëndetshëm.

## **QËLLIMET DHE DETYRAT E EKSKURSIONEVE SHKOLLORE**

### **Neni 4**

Ekskursionet shkollore synojnë të fitojnë dhe zgjerojnë njohuritë, të zhvillojnë interesat e ndryshme të nxënësve, të zbatojnë aftësitë dhe qëndrimet përmes njohjes së drejtpërdrejtë me fenomenet, si dhe marrëdhëniet në mjedisin natyror dhe shoqëror, monumentet kulturore dhe historike, kapacitetet industriale dhe bujqësore, në përputhje me punën edukativo-arsimore të shkollës.

### **Neni 5**

Detyrat e ekskursioneve shkollore janë:

-zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj vlerave kombëtare, artistike, shkencore dhe kulturore të përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

- njohja e kulturave të ndryshme dhe monumenteve në shtete të tjera;
- kërkime mbi tema dhe fusha të integruara në fushat natyrore, sociale dhe tekniko-teknologjike;
- zhvillimin e interesit dhe kujdesit për natyrën dhe praktikimin e zakoneve ekologjike;
- njohja e kulturës dhe mënyrës së jetesës së njerëzve në rajone të ndryshme;
- zhvillimi i ndjenjës për patriotizëm, tolerancë dhe bashkëjetësë;
- formimi i qëndrimit pozitiv ndaj vlerave kombëtare, ndërkombëtare, kulturore dhe estetike;

- inkurajimi dhe manifestimi i emocioneve pozitive, miqësisë dhe mbështetjes, solidaritetit dhe mirëkuptimit më të mirë të ndërsjellë;
- formimin e qëndrimeve demokratike, socializimin, mbrojtjen kolektive dhe përvetësimin e njohurive dhe përvojave të reja, dhe
- realizimi i nevojave për aktivitete sportive, rekreacion dhe krijimi i kulturës për jetesë të shëndetshme.

### **III. PLANIFIKIMI, PROGRAMIMI DHE KUSHTET PËR ORGANIZIMIN DHE REALIZIMIN E EKSKURSIONEVE SHKOLLORE**

#### **Neni 6**

Me programin vjetor të punës së shkollës përcaktohen plani dhe përmbajtja e ekskursioneve, të cilat përfshijnë realizimin e pjesëve nga plani mësimor dhe programet mësimore.

Këshilli shkollor me vendim formon ekip për përgatitjen e Programit për ekskursionet shkollore për vitin mësimor në vazhdim (në tekstin e mëtejshmë: ekipi).

Ekipi përbëhet nga: drejtori i shkollës, udhëheqësi i ekskursionit, udhëheqësit e klasave, bashkëpunëtorët profesionalë dhe disa nga mësimdhënësit të cilët për të paktën një vit kanë realizuar mësimdhënie në paralelet që do të marrin pjesë në ekskursion.

Mësimdhënësit nga paragrafi 3 i këtij nenit përcaktohen nga grupet profesionale të mësimdhënësve në shkollë.

Drejtori i shkollës emëron udhëheqësin e ekskursionit shkollore nga radhët e mësimdhënësve që realizojnë mësim në paralelet me të cilat do të realizohet ekskursioni shkollore.

Programi për ekskursionin shkollore duhet të përmbajë të dhëna për

- llojin e ekskursionit shkollore,
- qëllimet edukativo-arsimore,
- detyrat,
- përmbajtjet dhe aktivitetet,
- udhëheqësin e ekskursionit, mësimdhënësit dhe nxënësit,
- kohëzgjatja,

- vendet për vizitë dhe shikim,
- relacionet,
- organizimi teknik,
- mënyra e financimit.

Për përgatitjet me karakter profesional-pedagogjik, teknik-organizativ dhe të sigurisë, si dhe për realizimin e ekskursioneve shkollore, kujdeset ekipi.

### **Neni 7**

Për çdo Program të ekskursioneve shkollore që hartohet nga ekipi, jep mendim Këshilli i prindërve të shkollës, përveç në rastin e ekskursioneve që lidhen me tema dhe përbajtje nga programet që janë të detyrueshme dhe përfshijnë vizitë në shfaqje teatrale, vizitë në opera dhe balet, si dhe vizita në muze në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Mendimi për ekskursionet dhe shëtitjet shkollore, nga ana e Këshillit të prindërve, i dorëzohet shkollës më së voni pesë ditë nga dita e pranimit nga ana e ekipit.

Në bazë të mendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, Këshilli i shkollës e miraton programin për ekskursionet shkollore të paktën pesë ditë para realizimit të ekskursionit.

### **Neni 8**

Gjatë organizimit dhe realizimit të mësimit sipas programeve të shkurtuara mësimore, në kushte të jashtëzakonshme (kur është konstatuar gjendje krize, është shpallur epidemi ose pandemi, zjarre, përbajtje dhe fatkeqësi të tjera të mëdha natyrore), ose gjatë organizimit të mësimit në distancë, shkolla nuk përgatit Program për ekskursionet shkollore.

Nëse këshilli i shkollës ka miratuar Programin për ekskursionet shkollore para shpalljes së rrethanave të jashtëzakonshme nga paragrafi 1 i këtij neni, ai program pezullohet deri në përfundimin e rrethanave të jashtëzakonshme.

### **Neni 9**

Gjatë organizimit dhe realizimit të mësimdhënies që zgjat më pak se 180 ditë mësimore, si dhe gjatë realizimit të mësimdhënies sipas programeve të shkurtuara në kushte të jashtëzakonshme (është konstatuar gjendje krize, është shpallur epidemi ose pandemi, zjarre, përbajtje apo fatkeqësi të tjera të mëdha natyrore), ose

gjatë organizimit të mësimit në distancë, shkolla mund të planifikojë dhe të organizojë dy shëtitje njëditore me nxënësit gjatë viti shkollor – një në vjeshtë dhe një në pranverë – të cilat realizohen në kohëzgjatje deri në pesë orë për qëllime sportive-rekreative, edukative dhe arsimore.

Shëtitjet sportive-rekreative nga paragrafi 1 i këtij neni organizohen në afërsi të menjëherëshme të shkollës, pa përdorimin e transportit publik.

Shëtitjet organizohen në nivel të viti, por jo më shumë se dy paralele në të njëjtën ditë dhe në lokacionin e njejtë.

Gjatë organizimit të shëtitjeve respektohen të gjitha protokollet dhe rekomandimet, në përputhje me kushtet në të cilat organizohen.

Plani dhe organizimi i shëtitjeve miratohen nga këshilli i shkollës.

## Neni 10

Pas marrjes së pëlqimit për realizim, ekskursioni shkollor organizohet dhe realizohet me pajtimin e të paktën 20% të prindërve të nxënësve që janë të përfshirë në ekskursion, përvèç ekskursioneve që lidhen me temat dhe përbajtjet nga programet mësimore që janë të detyrueshme për të gjithë nxënësit.

Për nxënësit që nuk marrin pjesë ose nuk shkojnë në ekskursion, shkolla organizon mësim të rregullt.

## Neni 11

Ekipi harton Kod të sjelljes dhe veshjes së nxënësve gjatë ekskursioneve shkollore.

Kodi i sjelljes dhe veshjes së nxënësve përmban:

- respektim të detyrueshëm të ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të shtetit në të cilin realizohet ekskursioni përfundimtar;
- veshje të përshtatshme në përputhje me kodin e institucionit që vizitohet;
- përfaqësim dinjitoz të shkollës, qytetit dhe shtetit të tyre;
- ndalim të konsumimit të alkoolit, cigareve, si dhe ndalim të përdorimit dhe tregtimit të drogave;
- ndalim të mbajtjes së çfarëdo lloj arme;
- ndalim të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, sjelljes së dhunshme dhe

shkaktimit të dëmeve materiale;

- ndalim të largimit nga grupi pa lejen e mësimdhënësit përgjegjës, etj.

Bazuar në Kodin e sjelljes dhe veshjes, nxënësi dhe prindi/kujdestari i tij nënshkruajnë deklaratë se gjatë realizimit të ekskursionit do t'i respektojnë dispozitat e Kodit.

Deklaratën e nënshkruar, nxënësi ia dorëzon kujdestarit të klasës më së voni tri ditë para realizimit të ekskursionit.

Nxënësit që gjatë ekskursionit shkollor nuk e respektojnë Kodin e veshjes dhe sjelljes së nxënësve gjatë kohës së ekskursioneve, Këshilli i mësimdhënësve i ndalon pjesëmarrjen në ekskursionin shkollor të ardhshëm dhe propozon t'i shqyrtohet masë pedagogjike.

## Neni 12

Gjatë organizimit të ekskursioneve që lidhen me temat dhe përbajtjet nga programet, për vizitë në muze, operë, balet ose shfaqje teatrale, shkolla mund të planifikojë edhe vizita në institucionet e mëposhtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Galeria Kombëtare e Maqedonisë-Shkup, Muzeu i Nënë Terezës-Shkup, Muzeu Arkeologjik i Maqedonisë-Shkup, Muzeu i Luftës Maqedonase për Pavarësi-Shkup, Muzeu i Holokaustit të Hebrenjve në Maqedoni-Shkup, Kompleksi "Fshati Maqedonas"-Shkup, IN Muzeu Kombëtar i Maqedonisë, IN Muzeu i Shkencave Natyrore i Maqedonisë, IN Muzeu i Artit Bashkëkohor, IP Muzeu Kombëtar i Qytetit të Shkupit (Skupi, Muzeu i Çarshisë së Shkupit), Kisha "Shën Spasi" - Shkup, Manastiri "Fjetja e Virgjireshës së Bekuar" - Matkë, Manastiri "Shën Andrea" - Matkë, IN Muzeu - Gjevgjeli, IN Muzeu Kombëtar i Rajonit të Tetovës - Tetovë, Manastiri i Lesoçit "Shën Atanasi", IN Muzeu Kombëtar-Kumanovë, IN Muzeu "Dr.Nikolla Nezlobinski" - Strugë, IN Muzeu Historik - Krushevë, IN Muzeu Kombëtar i Maqedonisë Perëndimore në Republikën e Maqedonisë - LNÇ Kërçovë, IN Galeria e Arteve - Tetovë, Shtëpia Memoriale Kombëtare e Toshe Proeskit, IN Muzeu i Alfabetit Shqip - Manastir, INMTKM Muzeu -Manastir (Heraklea), INMTKM -Prilep, Manastiri "Shën Nikolla" - f.Manastir, Mariovë, INMTKM - Shtip, INMTKM - Strumicë, Manastiri "Shën Klementi dhe Pantelejmoni" - PILaoshnik, Kisha "Shën Jovan Bllagosllov" - Kaneo, INMTKM - Ohër, Kisha "Shën Sofia" - Ohër, Manastiri "Shën Naumi i Ohrit", IN për Menaxhimin e Vendndodhjes Arkeologjike "Stobi" - Gradsko, Kisha "Shën Gjergji" Kurbinovo, IK Qytetit të Negotinës, Muzeu Kombëtar Veles, IL Galeria e Muzeut Kavadar, IK Muzeu Kombëtar Sveti Nikol, Manastiri i Bigorskit "Shën Gjon Pagëzori", IK Qytetit të

Kratovës, Muzeu Lokal Arkeologjik dhe Historik "Terrakota" - Vinicë, Manastiri "Shën Gavril Lesnovski", Manastiri "Shën Joakim Osogovski", IL Muzeu i Qytetit Kriva Pallankë, Muzeu Lokal Demir Kapi, Koleksioni i Muzeut Resnjë, Koleksioni i Muzeut të Vallandovës, Manastiri "Shën Gjergji Pobedonosec" - Rajçicë, Manastir "Shën Bogorodica Preçista" - Kërçovë, Koleksioni i Muzeut "Iskra" - Koçan (IK i Maqedonisë), Eksposita e Muzeut, QK "Dimitar Berovski" - Berovë, Eksposítë muzeale në Qendrën Kulturore "Nikolla Jonkov Vapcarov" dhe Eksposítë historike në f.Razllovcë – Dellçevë, Manastiri "Fjetja e Virgjëreshës së Bekuar" – Eleusa, Eksposita muzeale e mineraleve dhe objekteve historike QK "Zlletovski rudar" – Probishtip, Manastiri "Shën Leontij" – Vodoçë, Manastiri "Shën Kryeengjelli Mihail" – Berovë, Muzeu Etnologjik i fshatit Ione Eftimovski Podmoçan – Resnjë, Manastiri "Shën Kryeengjelli Mihail" – Varosh, Kisha "Shën Nikolla" – Varosh, Etnomuzeu më i vogël f. Xhepçishtë, rajoni i Tetovës, manastiri "Fjetja e Virgjëreshës së Bekuar" - Treskavec, Manastiri "Shën preobrazhenie " - Xérze, Muzeu i f. Livadhi, Strugë.

### Neni 13

Ekskursioni i fundit për nxënësit e vitit të fundit realizohet në gjysëmvjetorin e parë të vitit të fundit ose në gjysëmvjetorin e dytë të vitit të mëparshëm arsimor.

Ekskursionet përfundimtare organizohen dhe realizohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në vende të tjera.

Për ekskursionin përfundimtar mund të paraqitet nxënësi i rregullt ndaj të cilit nuk i është shqiptuar masë pedagogjike – vërejtje para përjashtimit nga shkolla dhe i cili e ka respektuar Kodin e sjelljes dhe veshjes së nxënësve gjatë ekskursionit të mëparshëm.

Udhëheqësi i paraleles përgatit nxënësit për ekskursionin përfundimtar.

Prindi/kujdestari i mbulon të gjitha shpenzimet financiare për ekskursionet, ndërsa shkolla e mesme vepron vetëm si ndërmjetës në realizimin e ekskursioneve shkollore nga aspekti formal-juridik, pa pasur asnjë marrëdhënie debitor-kreditor me agjencinë turistike të zgjedhur.

Ekskursioni përfundimtar zgjat më së shumti gjashtë ditë, me së paku tri netë.

Në çmimin e ekskursionit përfshihen shpenzimet për udhëtim, ushqim dhe akomodim, si dhe shpenzimet për vizita në muze dhe vende të tjera me rëndësi.

Në çmimin nga paragrafi 6 i këtij neni është i përfshirë edhe sigurimi bazë i udhëtimit dhe shëndetësor, pa franshizë.

### **Neni 14**

Ekskursione kërkimore profesionale realizohen për nxënësit nga të gjitha vitet e arsimit të mesëm.

Ekskursionet profesionale dhe kërkimore janë domosdoshmërisht të lidhura me sektorin, aktivitetet e projektit ose përbajtjen e programuar nga shkolla dhe mund të realizohen maksimumi dy herë gjatë një viti shkollor në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në një vend tjetër.

### **Neni 15**

Ekskursione sportive dhe rekreative (aktivitete edukative verore dhe dimërore, kamping, pushime verore dhe dimërore) mund të organizohen dhe kryhen për nxënësit nga viti i I deri në të IV të arsimit gjatë pushimeve shkollore verore dhe dimërore.

Ato organizohen dhe realizohen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vende, lokalitete dhe objekte në të njëjtin rajon gjeografik ose në një rajon tjetër nga vendbanimi i nxënësve.

Për kamping, është e domosdoshme të sigurohen kushte dhe pajisje të veçanta.

Për kampingun, aktivitetet edukative verore dhe dimërore, është e nevojshme të përgatitet program i veçantë dhe të sigurohen kushte dhe pajisje të përshtatshme.

Programi për kampim, pushime verore dhe dimërore përbëhet nga dy pjesë:

- Pjesa e parë: përgatitjet, udhëtimi dhe kthimi,
- Pjesa e dytë: qëndrimi, trajnimi për not, ski ose lloj tjetër i sportit.

Për këto forma të aktiviteteve sportive-rekreative bëhen përgatitje të veçanta për nxënësit, si: përgatitje fizike, sigurimi i pajisjeve të përshtatshme, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e rrezikut.

### **Neni 16**

Gjatë ekskursionit ndalohet vizita në vende që mund të paraqesin rrezik për sigurinë ose që nuk janë të përshtatshme për moshën, interesat dhe qëllimet edukative-arsimore të nxënësve.

## **Neni 17**

Për nxënësit nga familje me rrezik social që nuk mund të marrin pjesë në ekskursione shkollore, drejtori mund të sigurojë pjesëmarrjen e tyre duke përdorur përfitimet që ofron agjencia që merr pjesë në realizimin e aktivitetave të përmendura, ose nga burimet vetanake të shkollës, donacionet, sponsorët dhe burime të tjera të shkollës.

## **V. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË ESKURSIONEVE SHKOLLORE**

### **Neni 18**

Ekskursionet shkollore për të gjithë nxënësit e së njëjtës paralele dhe vit mësimor organizohen dhe realizohen njëkohësisht, me qëllime dhe aktivitete të njëjta.

### **Neni 19**

Ekskursionet që lidhen me përbajtjet e programeve organizohen nga shkolla të paktën një herë në vit.

Ekskursioni përfundimtar organizohet një herë gjatë arsimit të mesëm dhe mund të zgjasë deri në gjashtë ditë.

Ekskursionet profesionale-kërkimore organizohen gjatë vitit shkollor, me kohëzgjatje nga një deri në tre ditë.

Ekskursionet sportive-rekreative organizohen në varësi të llojit të aktivitetit dhe kohëzgjatjes së tij, si vijon:

- kampimi organizohet me kohëzgjatje prej pesë deri në shtatë ditë, një herë në vit.
- aktivitetet edukative verore dhe dimërore, pushimet verore dhe dimërore organizohen me kohëzgjatje prej shtatë deri në dhjetë ditë, një herë në vit.

### **Neni 20**

Për zgjedhjen e subjektit juridik për realizimin e ekskursioneve, shkolla, në emër të prindërve, realizon procedurë për mbledhjen e ofertave me publikimin e shpalljeve në të paktën dy gazeta ditore, nga të cilat njëra duhet të jetë në gjuhën maqedonase dhe njëra në gazetat që publikohen në gjuhën që flasin të paktën 20% e qytetarëve që flasin gjuhë tjeter nga gjuha maqedonase. Njëkohësisht shkolla e vendos njoftimin në një vend të dukshëm në hyrje të ndërtesës shkollore.

Procedura realizohet nga komision i formuar me vendim të Këshillit Shkollor. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë: tre anëtarë nga radhët e prindërve

të gjeneratës për të cilin realizohet ekskursioni dhe dy anëtarë nga radhët e mësimdhënësve.

Kryetar i komisionit është njëri nga anëtarët e komisionit nga radhët e prindërve

Komisioni përgatit shpalljen në formë të ftesës për dorëzimin e ofertave, duke përmendur veçanërisht: numrin e nxënësve, përshkrimin e shërbimit, kushtet minimale dhe kriteret shtesë që duhet të plotësojë ofruesi, dokumentet që duhet të dorëzojë ofruesi, informacionet për vlerën e garancisë bankare për realizimin cilësor të kontratës, e cila mund të jetë nga 5% deri në 15%, si dhe afatin përfundimtar, vendin dhe mënyrën e dorëzimit të tyre. Shpenzimet për shpalljen e njoftimit janë në llogari të shkollës.

Përshkrimi i shërbimit përgatitet në përputhje me Programin për ekskursione dhe aktivitete të tjera të lira në shkollë.

Kushtet minimale dhe kriteret shtesë që duhet të plotësojë ofruesi përgatiten në përputhje me nenin 22 të kësaj rregullore.

Afati për dorëzimin e ofertës nuk duhet të jetë më i shkurtër se pesë ditë.

Komisioni do të kalojë në vlerësim nëse është marrë të paktën një ofertë. Komisioni realizon vlerësimin e ofertave, përgatit raport të vlerësimit dhe dorëzon propozim për zgjedhjen e ofruesit më të favorshëm ose propozim për anulimin e procedurës, brenda pesë ditëve të punës pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave

- Komisioni mund t'i propozojë këshillit të shkollës anulimin e procedurës në rastet e mëposhtme:
- nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë,
- nëse nuk është parashtruar asnjë ofertë e pranueshme, gjegjësisht nuk është parashtruar asnjë ofertë që i përbush plotësisht kërkesat,
- nëse çmimet në oferta janë më pak të favorshme se çmimet aktuale të tregut.

Këshilli i shkollës është i detyruar, në afat prej pesë ditëve pune nga dita e dorëzimit të raportit nga Komisioni, të sjell vendim për të zgjedhur ofertuesin më të favorshëm ose vendim për anulimin e procedurës.

## Neni 21

Në thirrjen për mbledhjen e ofertave mund të paraqiten personat juridik që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në të.

Ofertat duhet të përgatiten dhe dorëzohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shpallje. Ofertat nuk duhet të përbajnë zgjidhje alternative, por

duhet të jenë të përgatitura në mënyrë të saktë dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në përshkrimin e shërbimit, i cili është pjesë e ftesës për dorëzimin e ofertës.

Oferta që përmban elemente apo shërbime shtesë nuk do të ketë përparësi gjatë vlerësimit të saj.

Çmimet në oferta duhet të jenë fikse, pra nuk lejohet korrigjimi i çmimeve gjatë realizimit të kontratës.

## Neni 22

Kriter për ndarjen e kontratës për realizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera të kohës së lirë është çmimi më i ulët.

Kushtet minimale që duhet të përmbushë ofertuesi janë:

- të jetë i regjistruar për kryerjen e aktiviteteve të përshtatshme turistike në përputhje me rregulloret pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të paktën tre vjet dhe
- të përmbushë kushtet për transportin e grupeve të fëmijëve, në përputhje me Ligjin për Sigurinë në Trafikun Rrugor dhe Rregulloren për Kërkesat e Veçanta Teknike për Mjetet që Transportojnë Grupe Fëmijësh.

Kriteret shtesë janë:

- hotelet (sa yje dhe nëse akomodimi në një ose më shumë nëse bëhet fjalë për grup më të madh) dhe rezervimi paraprak,
- menuja për ushqim
- bileta të paguara për vizitë në monumente kulturore dhe historike,
- lloji i autobuseve turistike,
- pagesë me këste (ose deri para nisjes),
- angazhimi i mjekut,
- raste sociale (sa nxënës do të përfitojnë falas),
- shoqërues turistikë dhe
- udhërrëfyes turistikë jashtë shtetit.

Oferta e ofruesit që nuk i plotëson kushtet minimale dhe kriteret shtesë do të refuzohet nga komisioni si e papranueshme.

Komisioni nuk guxon të përcaktojë kushte minimale shtesë dhe kritere shtesë në shpalljen për mbledhjen e ofertave, përveç kushteve të përmendura në paragrin 2 dhe 3 të këtij neni.

### **Neni 23**

Ofertuesit e papërzgjedhur kanë të drejtën e ankesës, nëpërmjet shkollës, te kryetari i komunës /Qytetit të Shkupit, gjegjësisht te Ministria e Arsimit dhe Shkencës për shkollat shtetërore, brenda tetë ditëve nga data e marrjes së vendimit për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme.

Kryetari i komunës, përkatësisht ministri i Arsimit dhe Shkencës, formon komision nga radhët e punonjësve për të vendosur mbi ankesën nga paragrafi 1 i këtij neni.

Shkolla, në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit, duhet t'ia dorëzojë ankesën kryetarit të komunës, përkatësisht Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me të gjithë dokumentacionin nga procedura e zhvilluar.

Kryetari i komunës, përkatësisht Ministri i Arsimit dhe Shkencës, duhet të vendosë për ankesën brenda 15 ditëve nga data e pranimit të ankesës.

### **Neni 24**

Udhëheqësit e paraleljeve i njoftojnë prindërit me përzgjedhjen e realizuar të ofertuesit më të favorshëm, kushtet e dakorduara dhe mënyrën e organizimit dhe realizimit të ekskursionit shkollor, si dhe me shumën financiare të nevojshme për pjesëmarrje në ekskursion, më së voni brenda 10 ditëve nga dita e përzgjedhjes përfundimtare të ofertës më të favorshme.

Kjo procedurë zhvillohet para nënshkrimit të kontratës, duke pasur parasysh se në kontratë duhet të përfshihet numri i saktë i nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion.

### **Neni 25**

Drejtori i shkollës do të lidhë kontratë me ofertuesin që ka ofruar çmimin më të ulët dhe që i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 22, paragrin 2 dhe 3 të kësaj Rregullore.

Kontrata e lidhur nga drejtori i shkollës me ofertuesin duhet të përbajë gjithçka që është shenuar në ofertë, në përputhje me kërkesën për oferta, si:

-çmimi total i shërbimit për nxënës i cili përbëhet ng akomodimi, transporti, biletat për vizitë të monumenteve kulturore dhe historike, dhe ushqim;

- kushtet e akomodimit, menuja e ushqimit dhe transporti;
  - në çmim përfshihet edhe sigurimi bazë dhe shëndetësor i nxënësve pa franshizë;
  - mënyra e pagesës;
- udhërrëfyes turistikë dhe guidë turistike jashtë vendit, numri i mësimdhënësve dhe i mjekut;
- lehtësira për nxënësit që vijnë nga kategori sociale të cenueshme.

Në afat prej shtatë ditëve pas nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur duhet të paraqesë garanci bankare realizimin cilësor të ekskursionit në vlerë prej 5% deri në 15% të vlerës totale të kontratës.

Pjesë përbërëse e kontratës janë edhe kushtet e parashikuara në ofertë dhe Programi i ekskursionit të shkollës.

## **Neni 26**

Para realizimit të ekskursionit, drejtori verifikon nëse janë siguruar autobusë në numër të mjaftueshëm, me ulëse, për akomodim të mirë dhe të sigurt të nxënësve.

Një ditë para realizimit të ekskursionit, drejtori duhet të marrë nga transportuesi që kryen transportin, dëshmi për gjendjen teknike të rregullt të mjetit për transport publik, në përputhje me ligjet aktualisht në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe procesverbal për kontroll teknik të jashtëzakonshëm të autobusit, jo më të vjetër se gjashtë muaj.

Shoferi i autobusit duhet të ketë vërtetim mjekësor jo më të vjetër se gjashtë muaj dhe vërtetim nga personi përgjegjës i transportuesit se nuk ka drejtuar mjetin 12 orë para nisjes

Drejtori nuk e miraton udhëtimin nëse autobusi nuk i plotëson kushtet e përmendura në lidhje me gjendjen teknike, numrin e nevojshëm të ulëseve dhe nëse autobusi nuk është i klimatizuar.

## **Neni 27**

Drejtëpërdrejtë para realizimit, ndërsa jo më vonë se shtatë ditë para realizimit të ekskursionit, udhëheqësit e paraleleve organizojnë takim me nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre, në të cilin i informojnë dhe japid sqarime të detajuara për programin që do të realizohet gjatë ekskursionit.

## **Neni 28**

Drejtori i shkollës, më së voni deri më 48 orë para fillimit të udhëtimit, e njofton organin kompetent për punë të brendshme për:

- transportuesin;
- vendin dhe kohën e nisjes së nxënësve; dhe
- numrin e autobusëve të angazhuar dhe numrin e nxënësve, mësimdhënësve dhe personave të tjerë të paraqitur.

Nëse nuk janë përmbushur kushtet e lartpërmendura, drejtori i shkollës do ta ndalojë realizimin e ekskursionit.

### **Neni 29**

Udhëheqësit e paraleles duhet të marrin nga prindërit (kujdestarët) të dhëna për gjendjen shëndetësore të nxënësve, të cilat ia dorëzojnë mjekut para nisjes.

Të dhënat shëndetësore të nxënësve mbahen konfidenciale.

Nëse gjatë ekskursionit nxënësi sëmuret ose lëndohet, mjeku është i detyruar të veprojë sipas kompetencave të tij profesionale dhe të kërkojë ndihmë në institucionin shëndetësor më të afërt. Në rast se nxënësi mbahet për trajtim mjekësor, me të duhet të qëndrojë një mësimdhënës, ndërsa nxënësit e tjerë vazhdojnë udhëtimin.

Udhëheqësi i ekskursionit është i detyruar ta njoftojë shkollën dhe prindërit e nxënësit të lënduar ose të sëmurë dhe të organizojë transportin për kthimin e tij në vendbanimin e tij.

## **VI. RAPORT PËR REALIZIMIN E EKSURSIONEVE SHKOLLORE**

### **Neni 30**

Menjëherë pas realizimit të ekskursioneve, ndërsa më së voni në afat prej tre ditëve, ekipi parashtron raport për ekskursionin shkollor të realizuar, me vlerësim për realizimin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Raporti shqyrtohet nga Këshilli i Mësimdhënësve dhe Këshilli i Prindërve,

ndërsa miratohet nga Këshilli i Shkollës.

Udhëheqësit e paraleles informojnë prindërit për raportin gjatë mbledhjeve me prindërit.

Nëse gjatë shqyrtimit të rapportit për realizimin e ekskursionit vlerësohet se ofruesit e shërbimeve nuk kanë respektuar detyrimet e dakorduara, shkolla është e detyruar të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të përmendura në kontratën e lidhur me ofruesin.

## VII.MBIKQYRJA

**Neni 31**

Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit brenda kompetencave dhe autorizimeve sipas Ligjit për Inspektimin Arsimor.

## VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

**Neni 32**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve të tjera të lira të nxënësve të shkollave të mesme nr. 07-9992/3 të datës 05.06.2014, nr. 07-9992/4 të datës 07.10.2014, nr. 13-11296/1 të datës 15.10.2020 dhe nr.13-3111/1 të datës 14.03.2023.

**Neni 33**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme pas ditës së miratimit të saj.

**Министерка за образование и наука,**

**Ministre e Arsimit dhe Shkencës,**

**проф. д-р Весна Јаневска**

Nr.13-10833/1

04.08.2025

Shkup